

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konferenca e Kryetarëve, PS rrezon kërkesën e PD për Komision Hetimor për KAYO: Nuk plotëson krite ret kushtetuese dhe ligjore
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/17/konferenca-e-kryetareve-ps-rrezon-kerkesen-e-pd-per-komision-hetimor-per-kayo-nuk-ploteson-kriteret-kushtetuese-dhe-ligjore/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 07:56:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 07:46:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 07:45:00 UTC → 17 shtator 2026, 07:47:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2e4268b7eca33d69d19bbbfa7f0cf74b35f2ae4ae62ba66bad93d384e7c07455
TEKSTI	1f68f5760fe27998894e025dbed6bd8cde38988164713e6f686abe95497165ff
PAMJA	9b5eb6248473cba90273f30f2cab1d5b0e6fe25ab0570e82b467f6fdbdbe910f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6d5ffbe226aaf34e1edf81bc41834bb2cdf62fa1e0b6eadb0854b24ec5907784
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	08125200eaf71731bdbb8a1cab166a4681f18204dc61aa429d5ceda9de8c2ea9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6d5ffbe226aaf34e1edf81bc41834bb2cdf62fa1e0b6eadb0854b24ec5907784>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KRYESORE POLITIKË TË FUNDIT

Konferenca e Kryetarëve, PS rrëzon kërkesën e PD për Komision Hetimor për KAYO: Nuk plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore

17/09/2026 09:46



Kërkesa e opozitës për ngritjen e një Komisioni Hetimor për veprimtarinë e kompanisë shtetërore KAYO nuk ka marrë dritën jeshile nga mazhoranca.

Vendimi është marrë gjatë mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve, ku është vlerësuar se kërkesa nuk përmbush kriteret kushtetuese dhe ligjore për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar.

Kërkesa ishte depozituar nga grupet parlamentare të Partisë Demokratike, Partisë së Lirisë dhe "Aleancës për Ndryshim", me firmat e 41 deputetëve. Opozita kërkonte një komision me 15 anëtarë dhe një mandat gjashtëmujor për të verifikuar veprimtarinë e KAYO-s, marrëdhëniet kontraktuale, përdorimin e fondeve publike dhe dyshimet për trafik ndërkombëtar armësh.

Në qendër të kërkesës së opozitës janë edhe pretendimet për 34 milionë euro të shpenzuara nga KAYO, si dhe audiopërgjimet e publikuara në media, për të cilat opozita kërkon verifikim parlamentar. Këto janë pretendime të paraqitura nga opozita dhe nuk përbëjnë, në vetvete, konstatime të provuara përfundimisht.

Duke mbrojtur kërkesën e opozitës, kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, deklaroi se qëllimi i një komisioni hetimor është pikërisht mbledhja dhe verifikimi i informacionit.

Sipas Bardhit, KAYO ka shpenzuar 34 milionë euro nga buxheti i shtetit, ndërsa opozita kërkon të dijë se çfarë ka përfituar shteti nga kjo veprimtari dhe si janë lidhur kontratat me kompanitë private.

"Ne nuk kërkojmë asgjë tjetër, veç të mësojmë dhe të njohim kontratat e lidhura mes një kompanie shtetërore me kompaninë private", deklaroi Bardhi, duke këmbëngulur se opozita është e gatshme të diskutojë objektin e hetimit.

Nga mazhoranca, kreu i Grupit të PS, Taulant Balla argumentoi se kërkesa nuk plotëson kriteret për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar.

Sipas arsyetimit të paraqitur, objekti i kërkesës është tepër i gjerë dhe përfshin çështje të ndryshme, pa përcaktuar në mënyrë të qartë faktet konkrete, veprimet apo mosveprimet që duhet të hetohen.

Në dokumentin e bërë publik thuhet se nuk janë individualizuar qartë kontratat, aktet apo veprimet konkrete që pretendohet se janë të paligjshme, ndërsa periudha kohore e hetimit nuk është përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme.

Mazhoranca vlerëson gjithashtu se tetë pikat e propozuara nga opozita kanë natyrë të ndryshme, duke përfshirë kontratat, aktivitetin tregtar dhe prodhues, fondet buxhetore,

I Kryesore



Sot seancë plenare/ Pesë interpelanca në rend dite, Kuvendi vendos edhe për pagat e gjyqtarëve e prokurorëve

07:37

Operacion antidrogë në Korçë, në pranga 3 të rinj, sekuestrohen 6 kilogramë kanabis

08:41

Haga dënoi me 81 vite burg liderët e UÇK-së, deputeti i PDK-së në "Top Story": U përmbys çdo ide e drejtësisë, Kosova viktimë e një rendi të ri

07:20

Trump kërcënon BE-në me tarifa pas propozimit për Kanadanë si anëtare e asociuar e bllokut europian: Nëse është akt armiqësor, do reagojmë

07:23

Kushte të qëndrueshme atmosferike, parashikimi i motit për këtë të enjte

07:10

I Më të lexuarat

Dënimi me 81 vite burg i ish-liderëve të UÇK, Vuçiç del në konferencë dhe ankohet: Nuk janë dënuar për krime kundër njerëzimit

Nuk kënaqet me 81 vite burg për ish-krerët e UÇK, Prokurorja e Specializuar e Hagës: Do kërkojmë në Apel dënim edhe për krimet kundër njerëzimit

Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së. Prishtina "ngrihet në këmbë" për Thačin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, protesta para institucioneve

Ish-krerët e UÇK-së u dënuan me 81 vite burg total, reagon Rama: Marre!

Vuçiçit nuk i del inati/ 'Studion' reagimet e zyrtarëve të lartë të rajonit pas vendimit në Hagë, ndalet te Begaj e Rama, 'kërcënon' Malin e Zi

Ekskluzive/ "Jam i rënduar psikologjikisht, Thačin tani do e kem më shumë mik", Majko i përlotur: Shqipëria e Kosova të shtrëngojnë dhëmbët dhe...

"Të respektohen vendimet e Hagës"/ Dënimi i liderëve të UÇK-së, Grenell i përgjigjet deklaratës së Marta Kos: Këto gjykata radikale duhet të mbyllen

"Apeli nuk do të sjellë ndryshime"/ Vendimi

dysimet për trafik armësh dhe detyrimet që lidhen me NATO-n.

Në arsyetimin e mazhorancës thuhet se raportimet mediatike, vendimet e Këshillit të Ministrave dhe audiopërgjimi i publikuar nuk përbëjnë në vetvete indicie të mjaftueshme për ngritjen e një komisioni hetimor.

Sipas këtij qëndrimi, një komision parlamentar nuk mund të ngrihet vetëm për të mbledhur informacion me qëllim që gjatë hetimit të përcaktohet nëse ekziston apo jo një paligjshmëri. Përpara ngritjes së komisionit, sipas mazhorancës, duhet të ekzistojnë të dhëna dhe indicie konkrete për një çështje të veçantë.

Një tjetër argument lidhet me verifikimet e nisura nga SPAK-u lidhur me audiopërgjimin e publikuar. Sipas arsyetimit të mazhorancës, një hetim parlamentar që do të përfshinte të njëjtat çështje mund të krijonte mbivendosje me hetimin penal, veçanërisht sa i përket autenticitetit dhe vlerësimit të provave.

Në përfundim, qëndrimi i paraqitur nga Taulant Balla është se çështjet e ngritura nga opozita mund të trajtohen përmes instrumenteve të tjera të kontrollit parlamentar, si pyetjet në komisione, pyetjet në seancë plenare dhe interpelancat.

Sipas tij, fakti që Ministria e Mbrojtjes nuk u është përgjigjur disa kërkesave për informacion nuk përbën, në vetvete, bazë të mjaftueshme për ngritjen e një komisioni hetimor.

Konferenca e Kryetarëve rrëzoi kështu kërkesën e opozitës për ngritjen e Komisionit Hetimor për KAYO-n, ndërsa debati politik pritet të vijojë lidhur me përdorimin e fondeve publike, aktivitetin e kompanisë shtetërore dhe pretendimet për tregtinë ndërkombëtare të armëve.

"Nga pikëpamja përmbajtësore, kërkesa nuk përmbush kriteret kushtetuese dhe ligjore për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar, në veçanti kriterin e ekzistencës së një "çështjeje të veçantë". Objekti i hetimit është konceptuar në mënyrë tepër të gjerë dhe përfshin një sërë çështjesh të ndryshme, pa individualizuar qartë faktin apo grupin e fakteve konkrete që duhet t'i nënshtrohen hetimit parlamentar."

Nuk janë përcaktuar veprime ose mosveprime konkrete të zyrtarëve publikë apo të përfaqësuesve të shoqërisë "KAYO" Sh.A., aktet ose kontratat konkrete që pretendohet se janë të paligjshme, si dhe periudha kohore në të cilën duhet të shtrihet hetimi. Në këtë mënyrë, objekti synon kontrollin e përgjithshëm të të gjithë veprimtarisë së shoqërisë dhe jo hetimin e një çështjeje të individualizuar me rëndësi të veçantë publike."

Edhe tetë pikat që përbëjnë objektin e propozuar kanë natyrë të ndryshme dhe heterogjene, duke përfshirë marrëdhënie kontraktuale, veprimtari prodhuese dhe tregtare në fushën ushtarake, fonde buxhetore, dyshime për trafik armësh dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj NATO-s. Një shtrirje e tillë e objektit nuk mundëson përcaktimin e saktë të kufijve të hetimit dhe nuk përmbush standardin kushtetues të një çështjeje të veçantë të shoqëruar me indicie të qarta."

Kërkesa nuk eidenton gjithashtu indicie konkrete dhe të mjaftueshme për paligjshmëri. Vendimet e Këshillit të Ministrave, krijimi i katër shoqërive të përbashkëta nga "KAYO" Sh.A. me partnerë privatë, raportimet mediatike dhe investigative, si dhe audiopërgjimi i publikuar, nuk përbëjnë në vetvete prova ose indicie të mjaftueshme që të krijojnë një dyshim të arsyeshëm për veprimtari të paligjshme."

Një komision hetimor parlamentar nuk mund të ngrihet me qëllimin e përgjithshëm të mbledhjes së informacionit për të verifikuar nëse gjatë hetimit mund të zbulohet një paligjshmëri. Për ngritjen e tij duhet të ekzistojnë paraprakisht të dhëna dhe indicie konkrete që provojnë ekzistencën e një çështjeje që kërkon kontroll parlamentar."

Nuk rezultojnë argumentuar në mënyrë të mjaftueshme as ekzistenca e një interesi publik të veçantë që ta bëjë të domosdoshëm hetimin parlamentar. Natyra e ndjeshme e sektorit të mbrojtjes dhe referencat ndaj kontekstit ndërkombëtar të blerjes dhe tregtimit të pajisjeve ushtarake mbeten argumente të përgjithshme, për sa kohë nuk shoqërohen me fakte konkrete që provojnë cenimin e sigurisë publike ose të një interesi të rëndësishëm shtetëror."

Fakti që Ministri i Mbrojtjes është pjesë e organeve drejtuese të shoqërisë "KAYO" Sh.A. nuk përbën, në vetvete, shkak të mjaftueshëm për ngritjen e një komisioni hetimor. Për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij, ministri mund t'i nënshtrohet

per lideret e UÇK-se, avokatja periotet ne 'Top Story': Edhe nëse 'Specialja' zhbëhet, nuk ka fuqi mbi dënimin e dhënë

Dënimi me burg për 4 liderët e UÇK-së, reagon komisionerja Marta Kos: Vendimet e Hagës duhet të respektohen

Plagoset me armë zjarri avokati në Durrës, policia në kërkim të autorit, zbardhen emrat

kontrollit parlamentar përmes komisioneve të përhershme, pyetjeve apo interpelancës në seancë plenare. Hetimi parlamentar, ndërkohë, nuk mund të përdoret për nxjerrjen e përgjegjësisë individuale të një personi të caktuar.

Një element tjetër lidhet me nisjen e verifikimeve nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për audiopërgjimin e publikuar në media. Megjithatë ekzistenca e një hetimi penal nuk përbën automatikisht pengesë për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar, përfshirja e së njëjtës çështje në objektin e hetimit parlamentar krijon rrezik për mbivendosje dhe ndërhyrje në kompetencat e organit të prokurorisë, veçanërisht për sa i përket verifikimit të autenticitetit dhe vlerësimit të provave.

Në këto kushte, kontrolli politik parlamentar rrezikon të depërtojë në sferën e kontrollit juridik dhe të krijojë konflikt kompetencash me organet e drejtësisë, në kundërshtim me parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve. Komisioni hetimor nuk mund të shndërrohet në një mekanizëm paralel të hetimit penal apo të ushtrijë presion institucional mbi procese hetimore në zhvillim.

Çështjet e ngritura në kërkesë mund të trajtohen edhe nëpërmjet instrumenteve të tjera të kontrollit parlamentar të parashikuara nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit, përfshirë pyetjet në komisione dhe në seancë plenare, pyetjet me shkrim dhe interpelancat.

Edhe mungesa e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion të paraqitura nga një deputet ndaj Ministrisë së Mbrojtjes nuk mund të shërbejë, në vetvete, si argument për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar. Një interpretim i tillë do të krijonte precedent që çdo mosdhënie përgjigjeje nga ekzekutivi ndaj një kërkesë parlamentare të shërbente si bazë për ngritjen e një komisioni hetimor.

Në përfundim, megjithatë kërkesa plotëson kriterin formal të numrit të deputetëve që e kanë nënshkruar, ajo nuk plotëson kriteret përmbajtësore kushtetuese dhe ligjore për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar. Mungesa e individualizimit të një "çështjeje të veçantë", objekti tepër i gjerë dhe i paqartë, mungesa e indicieve konkrete dhe të mjaftueshme për paligjshmëri, si dhe rreziku i mbivendosjes me kompetencat e organeve të drejtësisë, nuk krijojnë bazën e nevojshme për ushtrimin e kontrollit hetimor parlamentar në formën e kërkuar", u shpreh Taulant Balla.

Top Channel

I Kryesore »



Plagosi babanë e ish-bashkëjetueses, daja i Zegjine Çaushtit mbërrin në Gjykatën e Fierit, pritët të njihet me masën e sigurisë

17/09 09:49



"Lironi çunat!"/ Mbështetësit e protestuesve të arrestuar mblidhen para Gjykatës Penale të Tiranës

17/09 09:46



Zgjedhjet në Rusi pa surpriza të mëdha, por Kremli kërkon një sinjal të fortë për Putinin

17/09 09:32



Leo Messi është i pandalshëm, shënon golin e 100-të me Inter Miamin dhe fiton një tjetër trofe

17/09 09:17



E rëndë në Tiranë/ 12-vjeçarja abuzohet seksualisht nga tezja dhe djali i hallës, në telefonin e të miturës u zbuluan video intime dhe...

17/09 09:09



Vendimi i Hagës për liderët e UÇK-së/ Tensione edhe gjatë natës në Prishtinë, protestuesit godasin me mjete piroteknike selinë e EULEX

17/09 08:55

I Politikë »





Besfort Lamallari u lirua nga detyra, presidenti Begaj dekreton Ervin Demon si ministër të Brendshëm

17/09 09:16



"Protesta e ka bërë Ramën njeriun më të urreyer", Kuvendi i PD-së në Krujë, Berisha: Jemi njerëz të sheshit dhe moralit

16/09 19:21



Ish-krerët e UÇK-së u dënuan me 81 vite burg total, reagon Rama: Marre!

16/09 19:10



Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, reagon Spiropali: Gjykata nuk mund ta rishkruajë si projekt kriminal luftën e një populli për liri

16/09 16:57



Vendimi i Hagës për liderët e UÇK-së, reagon Berisha: Në Serbi ka festë, por asgjë nuk e errëson Luftën Çlirimtare të Kosovës

16/09 13:48



Parkimi me pagesë në Durrës, Këshilli Bashkiak diskuton kartën e rezidentit dhe tarifat

16/09 13:48

Na ndiqni:



I Video »



Top News – Hashash me karrotrec drejt Korçës. Tre të rinjtë kapen mat pranë Pogradecit, arrestohen



Top News – Sherri me thika në Sarandë. Tre të plagosur pas zënkës, policia arreston dy të rinj



Top Channel/ Dënimet në Hagë, Vuçiçit nuk i del inati me shqiptarët, kërcënon e shpërthen ndaj Ramës



Top Channel/ BE ndalon rrjetet sociale nën 13 vjeç: Mbrojmë fëmijët



Top Channel/ Durrës, plagoset avokati, një 61 vjeçar e qëlloi me armë zjarri



Top Channel/ Avokatët e Thacit & Co: Do ta apelojmë, vendim i paracaktuar

Lajme	Bota	Sport	Pop News	Programe	Top Channel
Lajmet e fundit	Opinion	Kombëtarja	Showbiz	Big Brother VIP	Rreth Top Channel
Politikë	Koment	Kategoria Superiore	Lifestyle	Për'puthen	Topin e kam unë – Apliko tanil
Kronikë	Kosova dhe Rajoni	Kategoria e Parë	Fashion	Shqipëria LIVE	Kontakt
Aktualitet	Shkencë dhe Teknologji	Premier League	Shëndeti	Fiks Fare	Puno në Top Channel
Ekonomi	Auto	La Liga	Dieta	Video	Privacy Policy & Terms of Use
Sociale		Serie A	Receta gatimi	Të gjitha programet	Aksesueshmëria
Video		Shumësportësh		Guida TV	
Top News LIVE		Sport Gossip			

© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.